



UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan,
Republika e Kosovës www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

**RAPORT PËR VLERËSIM TË STAFIT AKADEMIK SI DHE LËNDËVE NGA
STUDENTËT E UNIVERSITETIT ‘KADRI ZEKA’, PËR SEMESTRIN DIMËROR
TË VITIT 2025/2026**

Divizioni për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	3
2. Metodologjia e hulumtimit.....	3
2.1 Qëllimi i hulumtimit.....	3
2.2 Metodat e hulumtimit.....	3
3. Rezultatet e Hulumtimit.....	4
3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit.....	4
3.2. Analiza e pyetësorëve	4
3.2.1 Rezultatet e vlerësimit të mësimdhënësve të UKZ-së nga studentët sipas Njësive Akademike.....	4
4. Analiza e pyetësorëve	4
4.1 Qëndrimet e studentëve të Njësive Akademike në raport me pohimet e shprehura në pyetësor	4
5. Përfundimet dhe rekomandimet	19

1. Hyrje

Matja e performancës e mësimdhënësit gjatë ligjëratave me studentë është një ndër matjet e rëndësishme për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies. Rezultatet e studentëve ndërlidhen me planifikimin e punës nga ana e mësimdhënësit, organizimin e orëve mësimore, përdorimin e materialeve të duhura për lëndë, kreativitetin e tyre si dhe zbatimin e metodologjive bashkëkohore gjatë organizimit të orës mësimore.

Duke u bazuar në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit në UKZ (Ref.nr.01/2913 dt. 18/12/2023) si dhe Manualin për Planifikim dhe Vlerësimi të Stafit Akademik (Ref.nr.01/2912 dt. 18.12.2023) është realizuar Vlerësimi i Stafit Akademik nga studentët për Semestrin Dimëror 2024/2025 në Universitetin “Kadri Zeka”.

Në kuadër të kësaj kemi plasuar pyetësorin në platformën SMU, kësaj radhe të kombinuar me pyetje edhe për lëndet edhe për performancën e mësimdhënësit.

2. Metodologjia e hulumtimit

2.1 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e problematikave të mundshme gjatë realizimit të plan programeve mësimore të mësimdhënësve në UKZ, trajtimin e lëndëve përkatëse si dhe qasjen në përgjithësi të obligimeve që mësimdhënësi ka ndaj lëndës dhe studentit. Për atë arsye përpjekja jonë e vazhdueshme është që të kemi rezultate sa më reale.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim vlera të cilat përcaktojnë shkallën e veprimit të mësimdhënësve brenda angazhimit të tyre profesional nëpër lëndë të caktuara të Programeve Studimore brenda Universitetit.

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t’u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimit i cili do të rekomandojë menaxhmentit të lartë të UKZ-së për të reflektuar mbi gjetjet e hulumtimit për periudhën e Semestrit Dimëror 2025/2026, për përmirësimet eventuale.

2.2 Metodat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të dhënave.

□ Shpërndarja e pyetësorëve

Objekt hulumtimi ishin shtatë Programet Studimore të nivelit baçelor Pyetësorët u vendosën në SMU gjatë periudhës së paraqitjes së provimeve për semestrin dimëror 2024/2025, po ashtu plotësimi i tyre u bë gjatë këtij afati kohor.

3. Rezultatet e Hulumtimit

3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit

Duke u bazuar në instrumentet për vlerësim që përmban Manuali për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së Stafit Akademik (Ref.nr.01/2912 dt. 18.12.2023), studentët kanë vlerësuar sipas Shkallës së Likertit, ku studenti për secilin konstatim është dashur të rrumbullakoj 1, 2, 3, 4 ose 5 (*5=pajtohem plotësisht; 4=pajtohem; 3=nuk e di; 2=nuk pajtohem; 1=aspak nuk pajtohem*).

Duke u mbështetur në Kalendarin Vjetor për Sigurim të Cilësisë, ku është paraparë që pas çdo Semestri të bëhet vlerësimi nga ana e studentëve. Divizioni për Zhvillim Akademik dhe Cilësi në bashkëpunim me KMCV-në si dhe Koordinatorët e Cilësisë janë përcaktuar forma dhe përmbajtja e pyetësorëve për semestrin dimëror të Vitit Akademik 2025/2026. Ku është vendosur që të vlerësohen edhe mësimdhënësit edhe lëndët e tyre.

Të gjithë studentët që iu kanë nënshtruar provimeve në afatin e Janarit kanë plotësuar pyetësorët.

Regjistrimin e pyetësorëve në formë elektronike e bëri Divizioni për Zhvillim Akademik dhe Cilësi. Duke u bazuar në Manualin për Planifikim dhe Vlerësimi të Stafit Akademik të gjithë mësimdhënësve të UKZ-së, rezultati i vlerësimit iu është dorëzuar në mënyrë individuale, në formë elektronike si dhe menaxhmenteve të fakulteteve u janë dorëzuar edhe raportet e përgjithshme për programe studimore dhe për fakultete në veçanti.

Për hartimin e Raportit me rezultatet e vlerësimit si dhe publikimin e rezultateve ka punuar kryesisht Divizioni për Zhvillim Akademik dhe Cilësi.

3.2. Analiza e pyetësorëve

3.2.1 Rezultatet e vlerësimit të mësimdhënësve të UKZ-së nga studentët sipas Njësive Akademike

.

4. Analiza e pyetësorëve

4.1 Qëndrimet e studentëve të Njësive Akademike në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Qëndrimet e përgjithshme të studentëve të Fakultetit të Edukimit për semestrin dimëror 2025–2026, të paraqitura në Tabelën 9, reflektojnë një nivel shumë të lartë të kënaqësisë me cilësinë e procesit mësimor. Nota mesatare e përgjithshme prej **4.69** dëshmon për një mjedis akademik cilësor dhe një përkushtim të lartë të stafit mësimdhënës.

Përgatitja e mësimdhënësve për lëndët që ligjërojnë është vlerësuar me **4.72**, duke treguar kompetencë të lartë akademike dhe profesionalizëm. Rregullsia dhe respektimi i orarit të

ligjëratave janë vlerësuar me **4.69**, çka reflekton seriozitet dhe përgjegjësi në realizimin e procesit mësimor.

Qartësia e qëllimeve dhe objektivave në syllabus është vlerësuar me **4.69**, ndërsa inkurajimi i diskutimeve dhe aktiviteteve në klasë gjithashtu me **4.69**, duke dëshmuar për një qasje interaktive dhe gjithëpërfshirëse në mësimdhënie. Kreativiteti në zhvillimin e mësimi është vlerësuar me **4.64**, duke treguar angazhim për forma dinamike të ligjërimit.

Përmbajtja e planprogrameve është konsideruar në përputhje me literaturën bashkëkohore me notën **4.70**. Materialet e lëndës janë vlerësuar si të disponueshme (**4.67**) dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive (**4.68**). Ambienti në orën mësimore, që inkurajon shprehjen e lirë të mendimeve dhe ideve, është vlerësuar me **4.69**.

Sa i përket procesit të vlerësimit, studentët kanë vlerësuar vazhdimësinë e vlerësimit me **4.69** dhe drejtësinë në vlerësim me **4.67**, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje objektive dhe transparente. Disponueshmëria e mësimdhënësve për konsultime ka marrë notën **4.70**, duke dëshmuar mbështetje të vazhdueshme akademike për studentët.

Në tërësi, rezultatet tregojnë një performancë shumë të lartë të stafit akademik dhe një klimë pozitive mësimore në Fakultetin e Edukimit.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.72
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.69
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.69
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.69
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimi dhe aktiviteteve tjera	4.64
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.70
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.67
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.68
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje te mendimeve/ideve	4.69

10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.69
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.67
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.70
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.69

Tabela 9. Fakulteti i Edukimit (Baçelor)

Vlerësimet e studentëve për asistentët e Fakultetit të Edukimit, të paraqitura në Tabelën 10, tregojnë një nivel të lartë kënaqësie, me një mesatare të përgjithshme prej **4.68**.

Përgatitja e asistentëve për ushtrimet është vlerësuar me **4.66**, ndërsa qartësia gjatë ushtrimeve me **4.63**, duke reflektuar angazhim dhe përgatitje të mirë profesionale. Transparenca në punë është vlerësuar me **4.66**, kurse drejtësia në vlerësim me **4.61**, duke treguar një qasje të drejtë dhe korrekte ndaj studentëve.

Saktësia në respektimin e orarit ka marrë notën **4.70**, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera është vlerësuar me **4.65**. Aftësia për të krijuar aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme është vlerësuar me **4.64**.

Inkurajimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes aktive të studentëve ka marrë notën **4.72**, ndërsa mundësia që studentët të parashtrojnë pyetje lirshëm është vlerësuar me **4.71**. Kërkesa për interaktivitet gjatë ushtrimeve është vlerësuar me **4.69**, ndërsa sjellja profesionale në përputhje me rregulloren me **4.70**.

Disponueshmëria për konsultime ka marrë notën **4.73**, duke dëshmuar gatishmërinë e asistentëve për mbështetje të vazhdueshme akademike.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se asistentët përbëjnë një mbështetje të rëndësishme në procesin mësimor, duke kontribuar në krijimin e një ambienti bashkëpunues, profesional dhe efektiv për të nxënëit.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.66
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.63
3	Asistenti/ja është transparent	4.66

4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.61
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.7
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.65
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.64
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.72
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.71
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.69
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.70
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.73
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.68

Tabela 10. Fakulteti i Edukimit – Asistentet

Në tabelën 11, është paraqitur vlerësimi i mësimdhënësve të Fakultetit Juridik për semestrin dimëror 2025–2026 tregon një nivel të mirë të përgatitjes dhe angazhimit në procesin mësimor, me një **mesatare të përgjithshme prej 4.32**.

Përgatitja e mësimdhënësve për lëndët është vlerësuar me **4.38**, duke reflektuar kompetencë të qëndrueshme profesionale. Rregullsia dhe respektimi i orarit të ligjëratave kanë marrë notën **4.37**, ndërsa qartësia e qëllimeve dhe objektivave në syllabus është vlerësuar me **4.34**, duke treguar një strukturim të mirë të përmbajtjes së lëndëve.

Inkurajimi i diskutimeve dhe aktiviteteve në klasë është vlerësuar me **4.28**, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimit me **4.32**, çka tregon një angazhim të mirë, por edhe hapësirë për rritje në aspektin e metodave më interaktive. Përmbajtja e planprogramit në përputhje me literaturën bashkëkohore është vlerësuar me **4.33**.

Materialet e lëndës janë vlerësuar me **4.26**, ndërsa ndikimi i tyre në zhvillimin e njohurive dhe aftësive me **4.33**, duke treguar se studentët i konsiderojnë materialet përgjithësisht të dobishme. Ambienti mësimor që inkurajon shprehjen e lirë të mendimeve është vlerësuar me **4.32**.

Sa i përket procesit të vlerësimit, vazhdimësia në vlerësim është notuar me **4.30**, ndërsa drejtësia në vlerësim me **4.25**, që paraqet një nga vlerësimet relativisht më të ulëta në

krahasim me pohimet tjera. Disponueshmëria për konsultime është vlerësuar me **4.31**, duke reflektuar një mbështetje të mirë, por me mundësi për përmirësim të mëtejshëm.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë një nivel të kënaqshëm të mësimdhënies në Fakultetin Juridik, me performancë stabile në të gjitha dimensionet e vlerësuara.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.38
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.37
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.34
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.28
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.32
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.33
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.26
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.33
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje te mendimeve/ideve	4.32
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.30
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.25
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.31
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.32

Tabela 11. Fakulteti Juridik

Vlerësimi i asistentëve të Fakultetit Juridik për semestrin dimëror 2025–2026 (tabela 12) reflekton një performancë të mirë, me një **mesatare të përgjithshme prej 4.28**.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.30
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.28
3	Asistenti/ja është transparent	4.22
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.09
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.3
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.28
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.29
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.26
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.33
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.35
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.32
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.32
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.28

Tabela 12. Fakulteti i Juridik – Asistentet

Vlerësimi i asistentëve të Fakultetit Juridik për semestrin dimëror 2024-2025 reflekton një performancë të kënaqshme, me një notë mesatare të përgjithshme prej 4.44. Përgatitja e asistentëve për ushtrimet e lëndëve është vlerësuar me 4.48, duke treguar një angazhim të mirë në shpjegimin e koncepteve dhe ushtrimeve praktike. Qartësia gjatë ligjëritimit në ushtrime ka marrë një vlerësim prej 4.44, duke dëshmuar përpjekjet e asistentëve për të komunikuar në mënyrë efektive me studentët.

Sa i përket transparencës dhe drejtësisë në vlerësim, këto janë vlerësuar me 4.42 dhe 4.38, duke treguar një qasje përgjithësisht të drejtë dhe objektive në procesin e vlerësimit të studentëve, megjithëse mund të ketë hapësirë për përmirësime të mëtejshme në këtë aspekt.

Saktësia në respektimin e orarit ka marrë një notë prej 4.42, duke treguar një disiplinë të mirë në mbajtjen e orëve të ushtrimeve.

Kreativiteti në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve shtesë, si dhe aftësia për të krijuar aktivitete që ndihmojnë në kuptimin e lëndës, janë vlerësuar me 4.41 dhe 4.42, duke treguar një përkushtim në zhvillimin e metodave të ndryshme pedagogjike për të ndihmuar studentët. Asistentët kanë inkurajuar bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në nivelin 4.41, ndërsa aftësia për të krijuar një ambient ku studentët mund të bëjnë pyetje lirshëm ka marrë një vlerësim të lartë prej 4.46.

Një aspekt i rëndësishëm është kërkesa për interaktivitet gjatë ushtrimeve, e cila është vlerësuar me 4.43, si dhe sjellja e asistentëve në përputhje me rregulloren, e cila ka marrë notën 4.47, duke treguar profesionalizëm dhe etikë në marrëdhënien me studentët. Disponueshmëria e asistentëve për konsultime është vlerësuar me 4.46, duke dëshmuar për një qasje mbështetëse ndaj studentëve jashtë orëve të ushtrimeve.

Në përgjithësi, asistentët e Fakultetit Juridik kanë demonstruar një performancë të mirë në aspektin akademik dhe profesional, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për të nxënit dhe duke ofruar ndihmë të vazhdueshme për studentët. Megjithatë, ka hapësirë për përmirësime në transparencën dhe drejtësinë në vlerësim, si dhe në krijimin e metodave më inovative dhe interaktive të mësimdhënies për të rritur angazhimin e studentëve.

Vlerësimi i studentëve për mësimdhënësit e Fakultetit Ekonomik për semestrin dimëror 2024–2025 tregon një nivel të lartë të përgatitjes dhe angazhimit akademik, me një **mesatare të përgjithshme prej 4.35**.

Përgatitja e mësimdhënësve për lëndët është vlerësuar me **4.50**, ndërsa rregullsia dhe respektimi i orarit të ligjëratave ka marrë **4.40**. Qartësia e qëllimeve dhe objektivave të lëndës në syllabus është vlerësuar me **4.36**, duke treguar një strukturim të qartë dhe të kuptueshëm të materialeve.

Inkurajimi i diskutimeve dhe aktiviteteve në klasë ka marrë **4.31**, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimin me **4.25**, duke treguar hapësirë për përdorim më të madh të metodave interaktive. Përmbajtja e planprogramit në përputhje me literaturën bashkëkohore është vlerësuar me **4.34**, ndërsa disponueshmëria e materialeve dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e njohurive janë 4.28 dhe 4.34. Ambienti mësimor që inkurajon shprehjen e ideve ka marrë **4.30**, duke reflektuar një atmosferë pozitive për debat akademik.

Vlerësimi i vazhdueshëm i studentëve ka marrë **4.30**, ndërsa drejtësia në vlerësim **4.35**. Disponueshmëria e mësimdhënësve për konsultime është vlerësuar me **4.38**, duke dëshmuar gatishmërinë e tyre për të mbështetur studentët jashtë ligjëratave.

Në përgjithësi, performanca e mësimdhënësve është e lartë, me mundësi për përmirësime në përfshirjen më aktive të studentëve dhe përdorimin e metodave kreative në mësimdhënie.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.50
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.40
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.36
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.31
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.25
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.34
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.28
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.34
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.30
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.30
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.35
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.38
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.35

Tabela 13. Fakulteti Ekonomik

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.32
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.19
3	Asistenti/ja është transparent	4.21
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.21

5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.25
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.18
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.15
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.22
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.30
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.19
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.24
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.24
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.23

Tabela 14. Fakulteti Ekonomik - Asistentet

Vlerësimi i asistentëve për semestrin dimëror 2024–2025 reflekton një performancë të mirë, me një **mesatare të përgjithshme prej 4.23**.

Përgatitja e asistentëve për ushtrimet ka marrë **4.32**, ndërsa qartësia gjatë shpjegimeve është **4.19**. Transparenca dhe drejtësia në vlerësim janë vlerësuar me **4.21** secila, duke treguar një qasje përgjithësisht të drejtë, por me hapësirë për përmirësim. Saktësia në respektimin e orarit ka marrë **4.25**, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve me **4.18**. Aftësia për të krijuar aktivitete që ndihmojnë në kuptimin e lëndës ka marrë **4.15**.

Inkurajimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së studentëve është vlerësuar me **4.22**, ndërsa mundësia që studentët të bëjnë pyetje lirshëm me **4.30**. Kërkesa për interaktivitet gjatë ushtrimeve ka marrë **4.19**, ndërsa disponueshmëria për konsultime **4.24**. Sjellja profesionale në përputhje me rregulloren ka marrë **4.24**, duke dëshmuar etikë dhe profesionalizëm.

Në përgjithësi, asistentët e Fakultetit Ekonomik kanë treguar një qasje profesionale dhe mbështetëse në ushtrimet praktike. Megjithatë, rezultatet tregojnë mundësi për përmirësim në kreativitetin dhe përdorimin e metodave inovative për të rritur angazhimin e studentëve.

1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.32
2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.15
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.26
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.20
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.11
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.20
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.21
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.20
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.18
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.14
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.19
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.11
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.2

Tabela 14. Fakulteti I Shkencave Kompjuterike

Vlerësimi i studentëve për mësimdhënësit e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike për semestrin dimëror 2024–2025 tregon një **nivel të kënaqshëm të performancës**, me një **mesatare të përgjithshme prej 4.20**.

Përgatitja për lëndën është vlerësuar me **4.32**, ndërsa rregullsia dhe respektimi i orarit të ligjëratave ka marrë **4.15**. Qartësia e qëllimeve dhe objektivave në syllabus është **4.26**, duke reflektuar një strukturim të qartë të përmbajtjes.

Inkurajimi i diskutimeve dhe aktiviteteve në klasë ka marrë **4.20**, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimin është **4.11**, duke treguar nevojë për përdorim më të madh të metodave inovative dhe praktike. Përputhja e planprogramit me literaturën bashkëkohore është **4.20**, ndërsa disponueshmëria e materialeve mësimore ka marrë **4.21**. Ndikimi i materialeve në

zhvillimin e njohurive dhe aftësive është **4.20**, ndërsa ambienti mësimor që inkurajon shprehjen e mendimeve ka marrë **4.18**.

Vlerësimi i vazhdueshëm i punës së studentëve ka marrë **4.14**, ndërsa drejtësia në vlerësim **4.19**. Disponueshmëria për konsultime ka marrë **4.11**, duke reflektuar një përkushtim të pranueshëm ndaj studentëve jashtë orëve të ligjëratave.

Në përgjithësi, mësimdhënësit kanë treguar performancë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, me nevojë për të rritur kreativitetin dhe nxitjen e përfshirjes aktive të studentëve gjatë procesit mësimor.

Vlerësimi i asistentëve për semestrin dimëror 2024–2025 tregon një **nivel të mirë të performancës**, me një **mesatare të përgjithshme prej 4.40**.

Përgatitja për ushtrimet ka marrë **4.45**, ndërsa qartësia gjatë ushtrimeve është **4.41**. Transparenca dhe drejtësia në vlerësim janë **4.43** dhe **4.37**, duke reflektuar një proces të drejtë dhe të qartë për studentët. Saktësia në respektimin e orarit ka marrë **4.40**, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimin është **4.35**. Krijimi i aktiviteteve që ndihmojnë kuptimin e lëndës është **4.32**.

Inkurajimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së studentëve ka marrë **4.39**, ndërsa mundësia që studentët të bëjnë pyetje lirshëm ka marrë **4.44**. Interaktiviteti gjatë ushtrimeve është vlerësuar me **4.37**, ndërsa respektimi i rregullores ka marrë **4.43**. Disponueshmëria për konsultime është **4.40**, duke reflektuar përkushtim dhe gatishmëri për mbështetje akademike.

Në përgjithësi, asistentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike kanë treguar një nivel të mirë të angazhimit dhe profesionalizmit, me mundësi për përmirësim në kreativitet dhe përdorimin e metodave inovative për të rritur interaktivitetin dhe përfshirjen e studentëve në ushtrime.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.45
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.41
3	Asistenti/ja është transparent	4.43
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.37
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.40
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.35
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.32

8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.39
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.44
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.37
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.43
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.40
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.4

Tabela 15. Fakulteti I Shkencave Kompjuterike - Asistentet

Mësimdhënësit e Fakultetit të Shkencave Sociale, një fakultet i ri me program të ri që vlerësohet për herë të parë, kanë marrë një **mesatare të përgjithshme prej 4.53**, duke treguar një nivel të lartë të përgatitjes dhe angazhimit akademik.

Përgatitja për lëndën ka marrë **4.64**, ndërsa rregullsia dhe përpikëria në ligjërata është **4.55**, duke reflektuar disiplinë dhe seriozitet në mësimdhënie. Qartësia e objektivave në syllabus është **4.49**, ndërsa angazhimi për të nxitur diskutime dhe aktivitete në klasë ka marrë **4.53**, duke treguar një qasje motivuese dhe interaktive ndaj studentëve. Kreativiteti në zhvillimin e mësimi është **4.38**, duke lënë hapësirë për metoda më inovative.

Përputhshmëria e planprogramit me literaturën bashkëkohore është **4.50**, ndërsa disponueshmëria e materialeve mësimore ka marrë **4.46**. Ndikimi i tyre në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve është **4.54**, ndërsa ambienti që inkurajon shprehjen e ideve ka marrë **4.61**, duke krijuar një klimë pozitive për debat akademik.

Vlerësimi i vazhdueshëm i punës së studentëve është **4.46**, drejtësia në vlerësim **4.57**, dhe disponueshmëria për konsultime **4.51**, duke treguar një qasje mbështetëse dhe të drejtë ndaj studentëve.

Në përgjithësi, mësimdhënësit e këtij programi të ri kanë krijuar një standard të lartë akademik, duke përmbushur pritshmëritë e studentëve dhe duke nxitur një ambient mësimor të pasur dhe të efektshëm.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.64

2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.55
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.49
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.53
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.38
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.50
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.46
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.54
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.61
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.46
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.57
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.51
13	Komenti juaj lidhur me profesorin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.53

Tabela 16. Fakulteti Shkenca Sociale

Asistentët e Fakultetit të Shkencave Sociale janë vlerësuar me një **mesatare të përgjithshme prej 4.49**, duke treguar një angazhim dhe profesionalizëm të lartë në ushtrimet e lëndës.

Përgatitja për ushtrimet ka marrë **4.58**, ndërsa qartësia gjatë ushtrimeve është **4.50**.

Transparenca dhe drejtësia në vlerësim kanë marrë **4.55** dhe **4.50**, duke treguar një proces të hapur dhe të balancuar për studentët. Saktësia në respektimin e orarit është **4.34**, ndërsa kreativiteti në zhvillimin e mësimin është **4.47**. Krijimi i aktiviteteve që e bëjnë lëndën më të kuptueshme ka marrë **4.46**.

Inkurajimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së studentëve është **4.45**, ndërsa mundësia që studentët të bëjnë pyetje lirshëm ka marrë **4.54**. Interaktiviteti gjatë ushtrimeve është **4.45**, respektimi i rregullores **4.55**, dhe disponueshmëria për konsultime **4.46**, duke treguar një qasje mbështetëse dhe profesionale.

Në përgjithësi, asistentët e Fakultetit të Shkencave Sociale kanë treguar një performancë të jashtëzakonshme akademike dhe profesionale, duke kontribuar në një ambient të përfshirë dhe mbështetës për studentët dhe duke rritur suksesin e programit të ri.

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.58
2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.50
3	Asistenti/ja është transparent	4.55
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.50
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.34
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.47
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.46
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.45
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.54
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.45
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.55
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.46
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.49

Tabela 17. Fakulteti Shkencave Sociale- Asistentet

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.47

2	Mësimdhënësi/ja ka qenë i rregullt dhe ka ardhur me kohë në ligjërata	4.37
3	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.40
4	Mësimdhënësi/ja ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë	4.36
5	Mësimdhënësi/ja është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktiviteteve tjera	4.30
6	Përmbajtja e e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.38
7	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.35
8	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.37
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.35
10	Vlerësimi i punës me studentë është bërë në vazhdimësi	4.33
11	Mësimdhënësi/ja është i drejtë në vlerësim	4.36
12	Mësimdhënësi/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.35
13.	Komenti juaj lidhur me Profesorin dhe Lëndën	
	Mesatarja e përgjithshme	4.37

Tabela 18. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të Stafit Akademik të UKZ-së nga ana e studentëve

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Asistenti/ja është i/e përgatitur për ushtrimet e lëndës	4.42

2	Asistenti/ja është i/e qartë gjatë ushtrimeve	4.35
3	Asistenti/ja është transparent	4.36
4	Asistenti/ja është i/e drejtë në vlerësim	4.33
5	Asistenti/ja është i saktë në orë	4.37
6	Asistenti/ja është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.32
7	Asistenti/ja krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.30
8	Asistenti/ja inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.36
9	Studenti/ja lirshëm mund t'i bëjë pyetje Asistentit/es	4.42
10	Asistent/ja kërkon interaktivitet gjatë ushtrimeve	4.35
11	Sjellja e Asistentit/es është në përputhje me rregulloren	4.39
12	Asistent/ja është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.38
13	Komenti juaj lidhur me Asistentin	
	Mesatarja e përgjithshme	4.37

Tabela 19. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të Asistentëve të UKZ-së nga ana e studentëve

5. Përfundimet dhe rekomandimet

Rezultatet e përgjithshme nga Tabelat 18 dhe 19 tregojnë se stafi akademik dhe asistentët e Universitetit “Kadri Zeka” janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, me një **mesatare të përgjithshme 4.37 për mësimdhënësit dhe 4.37 për asistentët**, duke reflektuar një nivel të mirë profesionalizmi dhe përkushtimi në procesin mësimor.

Pikat kryesore të vlerësimit përfshijnë:

Përgatitja dhe qartësia akademike: Studentët kanë vlerësuar përgatitjen e mësimdhënësve (4.47) dhe asistentëve (4.42), si dhe qartësinë e shpjegimeve dhe objektivave të lëndës (4.40 dhe 4.35), duke treguar një standard të lartë akademik dhe komunikim efektiv.

Transparenca dhe drejtësia: Vlerësimet e drejtësisë dhe transparencës në vlerësim janë të larta, me 4.36 për mësimdhënësit dhe 4.36 për asistentët, që konfirmon një qasje të paanshme ndaj studentëve.

Disponueshmëria dhe mbështetja: Disponueshmëria për konsultime ka marrë nota 4.35 (mësimdhënësit) dhe 4.38 (asistentët), duke reflektuar gatishmërinë e stafit për t'i ndihmuar studentët jashtë orarit të ligjëratave.

Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja: Ambienti mësimor inkurajon pjesëmarrjen e studentëve dhe diskutimin e ideve (4.35 dhe 4.36), duke krijuar mundësi për një mësimdhënie interaktive dhe bashkëpunuese.

Fushat për përmirësim:

Kreativiteti dhe inovacioni në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve të klasës janë pak më të ulëta (4.30 për mësimdhënësit dhe 4.32 për asistentët), duke treguar nevojën për metoda më dinamike dhe angazhuese të mësimdhënies.

Krijimi i aktiviteteve që ndihmojnë kuptueshmërinë e lëndës mund të përmirësohet (4.30–4.35), për të rritur përfshirjen aktive të studentëve.

Përmbledhje:

Në përgjithësi, stafi akademik dhe asistentët e UKZ-së ofrojnë një **përvojë mësimore cilësore**, duke siguruar një balancë të mirë mes përgatitjes akademike, drejtësisë në vlerësim dhe mbështetjes së studentëve. Megjithatë, ka hapësirë për të rritur **kreativitetin, metodat interaktive dhe angazhimin e studentëve** gjatë procesit mësimor.

Rekomandimet e tona janë:

1. **Rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve:** Syllabuset të bazohen në rezultatet e të nxënit dhe të monitorohet realizimi i tyre gjatë semestrit.
2. **Zhvillim profesional i vazhdueshëm:** Mësimdhënësit dhe asistentët të marrin pjesë në trajnime, seminare dhe konferenca për metodat bashkëkohore të mësimdhënies.
3. **Metoda interaktive:** Organizimi i punëtorive dhe aktiviteteve brenda klasës për të rritur kreativitetin dhe pjesëmarrjen e studentëve.
4. **Vlerësim i vazhdueshëm dhe objektiv:** Respektimi i kritereve të vlerësimit dhe përmirësimi i praktikave për një proces më të strukturuar dhe të drejtë.
5. **Sigurimi i përputhshmërisë akademike:** Monitorimi i literaturës dhe planprogramit për të garantuar përputhje të plotë me standardet mësimore.
6. **Dosjet individuale për performancën:** Mbajtja e dosjeve për secilin staf akademik që përfshijnë vlerësime, trajnime dhe zhvillime profesionale.
7. **Koordinimi i planprogrameve:** Dekanët të sigurojnë një koordinim të përbashkët të kurrikulave dhe përditësimin e tyre sipas nevojave akademike dhe të tregut.
8. **Motivimi i stafit:** Zbatimi i shpërblimeve, mirënjohjeve dhe mundësive për avancim për stafin që ka treguar performancë të lartë.
9. **Investime në infrastrukturë:** Përmirësimi i ambientit mësimor dhe teknologjisë për mbështetje të procesit të të nxënit dhe kërkimit shkencor.

10. **Zhvillimi i kurseve inovative:** Hartimi i kurseve që lidhen me tregun e punës, teknologjitë e reja dhe trendet globale për të rritur aftësitë praktike të studentëve.
11. **Fuqizimi i kërkimit shkencor:** Promovimi i projekteve dhe bashkëpunimeve kërkimore midis stafit dhe studentëve.
12. **Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Rritja e shkëmbimeve me universitete dhe institucione të tjera për të sjellë përvoja dhe praktika të reja mësimore.

Këto masa synojnë forcimin e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimin e performancës së stafit dhe rritjen e përfshirjes së studentëve në Universitetin “Kadri Zeka”.